

Thirrje për Koncept Ide

Programi SEED “Mbështetje për Zhvillimin e Edukimit dhe Punësimit” i mbështetur nga **Agjencia Austriake për Zhvillim** zbatohet në tre vende – Shqipëri, Kosovë dhe Serbi dhe kontribuon në përmirësimin e aksesit të grave dhe të rinjve në tregun e punës, si dhe në barazinë gjinore duke mbështetur zhvillimet positive socio-ekonomike.

Programi tre-vjeçar SEED zbatohet në Shqipëri nga **Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”** dhe Volkshilfe Solidarität. Ai fokusohet në zhvillimin e partneritetit publik – privat ndërmjet Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, pushtetit vendor, institucioneve publike dhe bizneseve në bashkitë Shkodër, Pukë dhe Lezhë për kualifikimin profesional të përfutuesve sipas nevojave dhe kërkesave të tregut të punës dhe lehtësimin e aksesit të tyre në punësim.

Kjo thirrje bëhet nga “**SEED Albania - Support of Educational and Employment Development in Albania**” (**SEED Shqipëri – Mbështetje për Zhvillimin e Edukimit dhe Punësimit në Shqipëri**). Qëllimi i thirrjes është të përmirësojë cilësinë e edukimit në kuadrin e orientimit të biznesit dhe/ose minimizimit të barrierave për gratë dhe të rinjtë të përfshirë në sektorin e turizmit.

Programi SEED Shqipëri ka filluar në Janar 2014 dhe përfshin një sërë aktivitete të planifikuara për zbatim gjatë periudhës tre-vjeçare.

Thirrja përmban 2 kategori në sektorin e turizmit. Aplikimet në këtë thirrje mund të bëhen në këto dy fusha:

KATEGORIA 1: Përmirësimi i shërbimeve në sektorin e turizmit të vogël dhe të mesëm

Prioritet do t'u jepet atyre projekteve të cilat konkretisht japin modele të rritjes së cilësisë së shërbimit në sektorin e turizmit në zonat e sipërshënuara

Aktivitetet mund të përfshijnë:

- Inisiativa lokale për përmirësimin e shërbimit në sektorin e turizmit, ku të përfshihen gra dhe të rinj (me të punësuar dhe/ose drejtuar nga gra dhe të rinj; bujtina, turizmi familjar, grupet e formalizuara të grave dhe të rinjve artizanë, etj)
- Inisiativa për përmirësimin e standarteve të shërbimit në sektorin e turizmit familjar, të vogël e të mesëm (pajisje dhe shërbime që tregojnë qartazi ndryshim pozitiv në rezultate)
- Inisiativa të praktikave të studentëve të QFP Shkodër, të të rinjve dhe grave në shërbimet e hotelevisë, kulinarisë, guidave turistike në biznese të ndryshme të sektorit të turizmit.

KATEGORIA 2: Promovimi i sektorit të turizmit të vogël dhe të mesëm

Prioritet do t'u jepet atyre projekteve të cilat konkretisht japin modele të promovimit dhe nxitjes së përfshirjes në sektorin e turizmit duke targetuar shërbimin e turizmit të vogël dhe të mesëm me të punësuar dhe/ose drejtuar nga gra dhe të rinj; bujtina, turizmi familjar, iniciativat sipërmarrëse në agrikulturë, traditë etj. në zonat e sipërshënuara

Aktivitetet mund të përfshijnë:

- Inisiativa për promovimin e turizmit në një zonë lokale duke targetuar shërbimet, produktet dhe përdorimin e burimeve turistike të zonës që janë karakteristike dhe përbëjnë mundësi për të nxitur zhvillimin e turizmit familjar, të vogël dhe të mesëm, bujtinave, përfshirjes së grave dhe vajzave dhe të rinjve
- Inisiativa për promovimin e shërbimeve turistike nga bujtina, turizmi familjar, grupet e formalizuara të grave dhe të rinjve artizanë, etj)
- Inisiativa për promovimin e turizmit dhe shërbimeve turistike duke përdorur aspekte të traditës, kulturës, historisë etj

Kritere për aplikantët:

Në mënyrë që të jetë i pranueshëm për një grant, aplikanti duhet të jetë:

- **Subjekt publik dhe privat** (fizik ose juridik), i vogël dhe i mesëm, në sektorin e hotelerisë dhe turizmit, qendra të formimit profesional, organizata të shoqërisë civile apo operatorë tjerë turistik, bujtina etj, apo
- **Grupe joformale/formale të grave dhe të rinjve** me fokus në promovimin e turizmit vendor, në agrikulturë, artizanat dhe traditë lokale.
- **individë**

Që operojnë në bashkitë **Shkodër, Pukë, Lezhë**

Kushtet tjera:

- Veprimtaria parësore e aplikantëve duhet të jetë në sektorin e shërbimeve të turizmit dhe hotelerisë apo/edhe në sektor të ndërlidhur me të
- Aplikuesit duhet që drejtpërsëdrejti të janë përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me partnerët e tyre, duke mos u sjellë si një ndërmjetës;
- Subjektet fitimprurëse janë të pranueshme në kuadër të kësaj thirrje për aplikime;

Aplikuesit mund të dorëzojnë më shumë se një aplikim për Kategori. Aplikuesi nuk mund të marrë më shumë se 1 grant për kategori në kuadër të kësaj Thirrje për Aplikime.

Çdo grant i kërkuar në kuadër të kësaj thirrjeje për aplikime duhet të bjerë në mes të shumave vijuese [minimale dhe] maksimale:

- **Shuma minimale e kërkuar: EUR 700**
- **Shuma maksimale e kërkuar: EUR 1,500**

Kohëzgjatja

Projekti duhet të zbatohet në periudhën **Qershor – Tetor 2016**.

Për çdo informacion në lidhje me thirrjen, të gjithë të interesuarit mund të dërgojnë pyetjet e tyre me subjekt **“Interesim për Thirrje për Aplikim”** në adresën e email: info@cdc-tff.org deri më datën **27 Prill 2016**.

Koncept ideja të dërgohet elektronikisht në adresën e e-mailit: info@cdc-tff.org me subjekt: **“Koncept ide për grante SEED Shqipëri”**

Afati i fundit: Afati i fundit i dorëzimit të koncept idesë është data **2 Maj 2016, ora 19:00**

Gjuha e aplikimit: Aplikimi duhet të dorëzohet në **gjuhën shqipe**.

Vlerësimi dhe njoftimi i ideve fituese: Idetë fituese do të njoftohen brenda datës **9 Maj 2016** si dhe do t’u jepet **formulari i aplikimit të plotë** bashkë me **udhëzimet e aplikimit**

Prezantimi i koncept ideve fituese: Idetë fituese do të prezantohen brenda periudhës **20 Maj 2016**

Aplikimi i plotë: Afati i fundit i dorëzimit të aplikimit të plotë është data **31 Maj 2016, ora 19:00**